

RAPORT  
2000



REPUBLIKA E SHQIPERISE

**KKRT- KESHILLI KOMBETAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT**

Tel/ ++ 355 42 33326

Fax/ ++ 355 42 26287

Nr. 94/1 Prot.

Tirane, me 15/02/2001

**Lenda:** Dergohet raporti vjetor per ne Parlament

**KOMISIONIT PARLAMENTAR PER MJETET E INFORMIMIT PUBLIK**

**z. Halil Lalaj**

Bashkelidhur raporti “ Mbi veprimtarine vjetore 2000 te KKRT”.

**KRYETARI**

Sefedin ÇELA

## **Raport vjetor ne Kuvend**

### **KKRT dhe mediat elektronike ne Shqiperi, 2000**

Ne harkun e vitit 2000 KKRT licenoi 80 operatore private lokale e kombetare per transmetime radio e televizive, te shtrire gjeografikisht ne gjithe Shqiperine.

Zgjerimi i mediave ne Shqiperi, posacerisht i atyre elektronike, eshte ne nje fare menyre edhe tregues i zhvillimit normal demokratik, i tolerances ne politiken shqiptare, duke pranuar keshtu sfiden ndaj oponences qe ben fjala e lire, madje, le ta themi, edhe duke u ballafaquar me raste te shperdorimit te kesaj lirie.

#### **Administrata e KKRT, probleme**

Administrata e KKRT u sistemua ne ambjente pune, ende jo ne menyre perfundimtare, ne maj 2000.

Pa zyra, pa infrastrukturen me te domosdoshme, pra dhe pa personel te plote, u desh te punohej intensivisht ne disa drejtime per te permbushur obligimet ligjore.

Per vitin 2000 investimet prej 11.5 milione leke u realizuan ne masen 100%.

Kemi perfituar nga donacione sipas projektit DANIDA shumen prej 30.261 \$, per te krijuar bazen e domosdoshme me kompjutera, paisje zyre, salle monitorimi. Per keto dhurime, te inventarizuara, sipas ligjit, i eshte derguar informacion Komisionit Parlamentar per Mjetet e Informimit Publik dhe Kontrollit te Shtetit.

Shpenzimet, per paga, sigurime shoqerore, energji, telefon e te tjera, per arsyet e permendura me lart, u realizuan ne masen 51%.

Per vitin 2001 besojme se do te realizohen disa projekte te rendesishme si studioja levizese per studimin e spektrit te frekuencave, kompletimi i salles se monitorimit dhe informatizimi e perpunimi i te dhenave, etj me mbeshtetjen qe na u dha ne buxhet nga Parlamenti si dhe me vazhdimin e ndihmes nga Qeveria Daneze, per te cilet perfitoj nga rasti te shpreh mirenjohje.

#### **Ligji, aktet dhe procedurat per vendimmarrje**

Tre faktore baze percaktojne lirine e konsolidimin e mediave: 1. Ekzistenca e rregullave dhe sfida e pranimet te tyre; 2. drejtues te afte dhe menaxhim i suksesshem per te qene konkurrent ne tregun specifik; 3. niveli profesional dhe pergjegjesia.

Prej shtatorit 1998 eshte miratuar nga parlamenti ligji "Per radion dhe televizionin publik e privat ne Republiken e Shqiperise". Ne kete ligj, por edhe ne Kushtetuten e Shqiperise sanksionohen rregulla te pranuar boterisht e qe gjejne vend ne konventat nderkombetare: e drejta per te informuar e per t'u informuar, paanshmeria e plotesia e informacionit, pavaresia redaksionale e moslejimi i censure. Kufizimet kane te bejne me ruajtjen e privacise ne jeten e qytetareve, mbrojtjen e te miturve, mbrojtjen e te drejtes se autorit dhe moslejimin e fyerjeve e shpifjeve.

Si shihet, askush s'ka te drejte kontrolli mbi permbajtjen e programeve, qe do t'i zinin frymen lirise, nemos do ta kthenin ate ne farse.

Te gjitha aktet dhe vendimet e KKRT jane mbeshtetur ne ligjin “Mbi radion dhe televizionin publik e privat ne Republiken e Shqiperise”, ne ligjin per sistemin e taksave dhe ligje te tjera te karakterit juridik civil, si ate per shoqerite, etj.

Ne rrethana te ngritjes si institucion, me stafin dhe infrastrukturen e domosdoshme, paralelisht, KKRT filloi procesin duke hartuar e miratuar formularet e aplikimit, kriteret per licencim, Rregulloret e vecanta per licencimin e operatoreve sipas llojit e kategorise (per radio FM lokale e kombetare, per television tokesor lokal e kombetar, per transmetim radio e televizion me satelit, per transmetim me kabell, per programet radiotelevizive me perserites), si dhe rregulloren e formularet e vleresimit me pike per konkuruesit per licence transmetimi radio e televiziv kombetare.

Te gjitha keto akte jane hartuar e miratuar duke konsultuar modele te vendeve te tjera, me ndihmen e oponenten e eksperteve te huaj dhe te organizmave nderkombetare si nga Danimarka, ne kuadrin e projektit DANIDA, nga Keshilli i Europes, nga instituti amerikan IREX si dhe me monitorimin e perfaqesise se OSBE ne Shqiperi.

Nje sondazh i bere mbi aplikimet e paraqitura ne muajin prill 2000, tregoi se shume subjekte kishin mangesi ne dokumentacion, per mosnjohje te ligjit, per mungese pervoje ne kete veprimtari qe kish filluar spontanisht, e papenguar nga ligji, por as konform ligjit.

Ne kete suate, kur, per pasoje, mund te skualifikoheshin shumica e aplikuesve, gati te gjitha ne transmetim, KKRT e pa te domosdoshme te organizonte ne muajin maj 2000 Konferencen e Pare Kombetare te Transmetuesve Radiotelevizive, ne te cilen, me pjesemarrje te plote te gjitha aplikuesve, u sqaruan dhe u saktesuan shume probleme, mbeshtetur ne Kriteret e Licencimit, te cilat u shperndane per te gjitha pjesemarrsit.

KKRT lejoi terheqjen e plotesimin e dokumentave duke caktuar nje afat te ri per dorezimin e tyre, qe u mireprit dhe u respektua.

Gjate muajve te veres administrata e KKRT shqyrtoi me hollesi dokumentat e cdo aplikuesi, mbeshtetur ne nje Vendim te Keshillit, ku percaktohej Komisioni i eksperteve te KKRT, procedurat e shqyrtimit dhe dokumentacioni administrativ: relacione me shkrim e firme te cdo eksperti per secilin aplikim, relacion permbledhes nga Komisioni, me firmat e secilit per cdo aplikim, etj.

Mbi kete baze, ne mbledhjet e veta, Keshilli mori ne shqyrtim nje per nje te gjitha dosjet e aplikuesve, te shoqeruara secila me relacionet perkates te cdo eksperti si dhe relacionet permbledhes te Komisionit te Eksperteve. Ne baze te ketij dokumentacioni te plote, Keshilli kualifikoi shumicen e tyre per proceduren e metejshme te licencimit. Per te tjeret, me mangesi ne dokumentacion, vendosi nje afat rekursi.

Ne mbledhjet e datave 23 dhe 30 gusht, Keshilli licencoi operoret radio FM dhe televizive lokale dhe vendosi qe tri aplikime per radio FM dhe dhjete aplikime per televizion tokesor, te vazhdonin garen e metejshme te konkurimit per t’u licencuar per transmetime kombetare. Theksojme qe nje pjese e ketyre aplikuesve u kualifikuan per transmetim kombetar gjate periudhes se rekursit,

Ne mbledhjen e dates 30 tetor 2000, me Vendim nr.28, KKRT miratoi aktin “Per percaktimin e modaliteteve te inspektimit te subjekteve qe konkurojne per transmetime Radio e TV Kombetare”, ne te cilen caktoheshin ekspertet e KKRT, subjektet ku do te behej inspektimi, detyrimi qe modalitetet, Formularet e Vleresimit dhe ky vendim, t’u beheshin te njohura subjekteve, duke i pajisur ato me nje kopje te derguar me leter percjellese.

Gjithashtu, vendimi percaktonte qe grupi i eksperteve, per cdo subjekt qe do te inspektonte, do te hartonte nje raport, nje kopje e te cilit, e firmosur nga te dyja palet, do t'i lihej subjektit te inspektuar.

Per disa dite me rradhe, grupi i eksperteve, sipas vendimit, inspektoi gjendjen ne vend te 13 subjekteve ne konkurim, ne rrethet Tirane, Durres dhe Kukes.

Raportet e tyre, te firmosura nga te dy palet, jane te arkivuara.

Nderkohe, anetaret e Keshillit e pane me vend te bejne edhe vete nje vezhgim te cdo subjekt.

Ne daten 14 nentor u be mbledhja e KKRT per shqyrtimin dhe licensimin e subjekteve ne konkurim per transmetues kombetare.

Veç njohjes me dosjen e secilit aplikues dhe raportet nga komisionet per kualifikimin, te bera prezent nga mbledhjet e meparshme, Keshilli kishte per çdo konkurent aktin e inspektimit te firmosur nga komisioni i eksperteve dhe palet, nje relacion per çeshtje te veçanta, permbledhes, te komisionit si dhe tabelat e vleresimit me pike te komisionereve, sipas Formulareve te Vleresimit te njohura nga konkuruesit.

Keshilli vleresoi treguesit e paraqitur nga cdo konkurues, i gjykoi te argumentuara raportet e Komisionit te eksperteve, tabelat e vleresimit sipas formuleve te vleresimit dhe vendosi te shpalle fitues si transmetues televiziv kombetar privat **TV KLAN** dhe **TVA**, kurse tete konkurentet e tjere i licensoi si transmetues lokale ne dy zona licensimi, pra me mbulim teritori deri ne kater prefektura. U licensua si transmetues radio FM Kombetare "**Top Albania Radio**" dhe dy konkuruesit e tjere, Radio " +2" dhe Radio "Perla" u licensuan si transmetues lokale ne dy zona licensimi me mbulim teritori deri ne kater prefektura. Keto radio mund te vazhdojne garen per transmetues kombetare, sepse ende jane ne dispozicion per konkurim edhe tri frekuenca per radio FM me shtrirje kombetare.

Keshilli u ndal ne menyre te posaçme mbi objeksionet e dala ne media ne prag te ketij procesi, shqyrtoi dokumentacionin e aplikuesave, disa nene te ligjit Nr. 8410, posacerisht ato per dhenien e heqjen e licensave dhe mori vendimin, tashme te njohur.

Keshilli vleresoi se te gjitha ceshtjet e prekura ne media, nga pikpamja ligjore e vleresimit te dokumentacionit, edhe hapja e nje procesi, s'mund te penalizonin e shmangin nga gara askend, sepse KKRT s'duhet te paragjykonte vendimet e gjykates, pa e rrezuar kjo e fundit vendimin e meparshem.

Per me teper, neni 34/1 i ligjit Nr. 8410 "Per radion e televizionin publik e privat ne Republiken e Shqiperise" shprehet qarte:

"Keshilli Kombetar i Radios dhe Televizionit ka te drejte te heqe licencen e transmetimit kur: 1. eshte fituar sipas te dhenave te rreme te paraqitura ne kerkese..."

Ne votim moren pjese 5 antare te Keshillit, nga 5 qe ushtrojne mandatin.

Te gjitha ishin te nje mendimi me vleresimin. Nje antar i Keshillit, ishte i mendimit qe operatori i dyte televiziv kombetar privat te licensohej pas zgjedhjeve te vitit 2001. Deklarata e tij u shenua ne process verbal dhe u publikua.

Vendimi, si te gjitha vendimet e tjera te KKRT, eshte marre me kuorumin e duhur, sipas ligjit.

Vendimi u be i njohur permes nje njoftimi per shtyp, miratuar ne mbledhje, duke ia shperndare menjehere, ATSH, RTSH, dhe disa RTV private e mediave te shkruara. Sipas ligjit, vendimet e KKRT per licencat jane botuar ne Fletoren Zyrtare.

Ne shume vende, perpunimi teknik dhe administrimi i frekuencave konsiderohet nje mister profesional dhe shume profesioniste, ndoshta, keshtu do te deshironin ta mbanin.

Por liria, e drejta e çdo qytetari per te informuar dhe per t'u informuar dhe zgjerimi i vrullshem i mediave elektronike ne demokraci te reja ende te brishta, si Shqiperia, kerkojne qe administrimi I frekuencave te jete nje proces transparent, qe jo vetem aplikuesit per licensa por çdo qytetar te sfidoje procesin e vendimmarrjes.

Ne shoqerite si jona, ne tranzicion, ku ndodh te mos respektohet as ligji, ka pak norma etike te pranuar: ketu s'bejne dallim as mediat. Nocioni i konfliktit te interesit s'ka ende qytetari, pra liria, liria per te vepruar, liria edhe per te marre vendime, kthehet ne nje barre te rende, sepse ajo perfshin ne vetvehte pergjegjesine.

Ne nje proces konkurimi te gjere, KKRT kishte nje pergjegjesi te madhe: te jepte licënsë-privilegj per ato subjekte qe plotesonin kerkesat e ligjit, kriteret e perpunuar, permes procedurash verifikimi te dokumentacionit e te vendimmarrjes krejtësisht transparente.

Ritheksoj detyrimet ligjore dhe karten morale te organit vendimmarres sepse realiteti tregon se shume operatore radiotelevizive, edhe pse s'ka patur pengese ligjore per veprimtarine e tyre, do t'i neneshtrohen " rregullave te lojes", pra te ligjit duke u dhene fund praktikave te deritashme, qe do te thote prekje interesash.

Ne luften per t'u afirmuar profesionalisht edhe si biznese, por edhe per te mbijetuar, ndodh qe pasurite publike dhe ato te tjeterkujt perdoren shpesh per perfitime private. Edhe ne medien elektronike askush s'ka patur leje per frekuencat ku transmeton, apo nuk i eshte nenshtruar standardeve teknike e profesionale ne prodhim e transmetim. Nuk eshte paguar per kete pasuri publike, interferohej tek tjetri, madje transmetohej ne te njejten frekuence me nje fuqi me te madhe. Transmetohet reklame e s'dihet ne i neneshtrohet dikush detyrimeve fiskale. Piratohen programe te te tjereve, duke shkelur çdo te drejte pronesisë e te autorit, etj.

KKRT kreu, me kete proces, aktin e pare te detyrimit te saj ligjor: licënsimin e rregullimin e veprimtarise radiotelevizive dhe jo moslicënsimin e mos rregullimin e tyre. Mbetet qe te dy palet, permes bashkepunimit dhe nje procesi transparent, te hedhin hapa te sigurte kurdohere neperputhje me ligjin e pa krijuar precedente te shmangies prej tij, aq me teper te mosrespektimit apo shkeljes se tij.

### **Pse u konkurua vetem per dy operatore TV kombetare dhe kater radio FM kombetare private ?**

Ndryshe nga media e shkruar, operatorët radiotelevizive i nenshtrohen nje procesi licënsimi te posaçem edhe per arsye se perdorin nje resurs te kufizuar kombetar, spektrin e frekuencave.

Pikerisht mundesia e limituar per frekuenca ben qe licënsat per transmetime radiotelevizive te jene nje privilegj i atyre qe e fitojne kete te drejte duke konkuruar konform ligjesh dhe jo nje e drejte per çdo qytetar.

Dy organizma ne Shqiperi jane te ngarkuar me ligj per ndarjen e administrimin e frekuencave, pra per licënsimin e operatoreve: ERT- Enti Rregullator i Telekomunikacioneve dhe KKRT- Keshilli Kombetar i Radios dhe Televizionit, ky i fundit ekskluzivisht per transmetimet radiotelevizive.

Ende nuk kemi ne vendin tone nje studim te plote te brezit te frekuencave dhe te potencialit te sakte te frekuencave per sherbimet civile, pra dhe per transmetime radiotelevizive, ende nuk eshte hartuar e miratuar plani kombetar i radiofrekuencave, por

duhet te theksojme se rrjetet kombetare tokesore te televizionit dhe te radios me modulim ne frekuence, FM, koordinohen e miratohen me marreveshje nderkombetare.

Per rrjetet kombetare tokesore TV dhe radio FM te rajonit 1 ku ben pjese dhe Shqiperia, jane zhvilluar dy konferenca nderkombetare, njera ne Stockholm ne Qershor 1961 dhe tjetra ne Dhjetor 1984 ne Gjeneve.

Shqiperia nuk ka marre pjese ne Konferencen Nderkombetare "Marreveshja rajonale per zonen Europiane te Radiodifuzionit" te zhvilluar ne Stockholm ne Qershor 1961. Kjo konference eshte e vetmja e zhvilluar deri tani per perdorimin nga operatoret radiotelevizive te brezit 41 deri 960 MHz., brez qe perfshin transmetimet tokesore televizive dhe radio me modulim ne frekuence.

Te gjitha pjesemarresit e kesaj konference, neneshkrues te marreveshjes ne date 23 qershor 1961, kane regjistruar stacionet e tyre televizive te fuqishem te instaluar ose te parashikuar per t'u instaluar ne te ardhmen.

Keto stacione, pra dhe te Italise, Greqise dhe ish Jugosllavise jane te mbrojtur sipas nenit 2, pika 1 te marreveshjes se siperpermendur. Shqiperia jo vetem nuk ka qene pjesemarrse, por nuk ka regjistruar paraprakisht asnje stacion. Sipas nenit 11, pika 1 marreveshja angazhon administratat e vendeve neneshkruese ne raportet ndermjet tyre por nuk i angazhon ndaj administratave te vendeve qe nuk kane neneshkruar, pra ndaj Shqiperise.

Pas vitit 1967, RTSh filloi studimin per programin e pare TV tokesor te cilin e nisi me baze kanal C, 81-88 MHz, i vetmi kanal televiziv shqiptar i regjistruar ne konferencen rajonale speciale zhvilluar ne Gjeneve ne vitin 1960. Ky kanal ishte dhe eshte jashte brezit te lene ne dispozicion nga rregullorja e radiokomunikacioneve per radiodifuzionin dhe per me teper, ne pjesen 87.5 MHz deri ne 88 Mhz ne brezin per radio FM eshte krejt i pambrojtur.

Keto defekte dhe mangesi te administrates se asaj kohe u bene me te dukshem kur filluan bisedimet me fqinjet per te koordinuar rrjetin kombetar televiziv, sepse zhvillimi i vrullshem i televizionit dhe i telekomunikacioneve bene qe ne konferencen e Stockholmit, e vetmja per perhapjen televizive, brezi i caktuar per televizionin te reduktohej ne vetem 50 kanale.

RTSH, si perdorues i vetem i brezit te frekuencave televizive, ne bashkepunim me Komisionin Shteteror te Radiokomunikacioneve, gjate viteve '70 dhe '80 ka bere perpjekje per te koordinuar me fqinjet tre rrjete televizive kombetare por nuk ka arritur marreveshje te shkruar me ta. Verbalisht, me administratat perkatese italiane dhe greke eshte arritur te koordinohen dy rrjete televizive, njeri ne UHF qe, sipas nenit 70 te ligjit "Per radion dhe televizionin ne Republiken e Shqiperise" i takojne RTSH-se.

Shqiperia eshte vend i vogel por edhe teper malor. Mbulimi i 90 % te territorit me sinjal, detyrim i ligjit, kerkon nga operatoret private qe do te kene licence kombetare me shtrirje tokesore qe te ngjiten ne lartesi te medha dhe te perdorin transmetues te fuqishem. Kjo e kufizon akoma me shume numrin e rrjeteve kombetare.

Per krahasim, Franca dhe Anglia kane pese rrjete kombetare televizive kombetare tokesore dhe Greqia ka gjashte te tille.

Pra, mund te themi se Shqiperia mund te perballoje jo me shume se kater rrjete kombetare tokesore, dy publike e dy private. Behet fjale ketu ne kuptimin teknik, te frekuencave me shtrirje tokesore kombetare, dhe jo te mundesive te tregut, ne se siguron apo jo burime te ardhurash per keto rrjete tokesore televizive, apo te teknologjive dixhitale.

Ne Konferencen Administrative Rajonale per planifikimin e transmetuesve radio me modulim ne frekuence, zhvilluar ne Gjeneve ne Dhjetor 1984, Shqiperia ishte pjesemarrëse dhe neneshkruese e Marrevshjes. Aty u paraqiten gjashte rrjete radio FM kombetare dhe u koordinuan kater. Lidhur me dy rrjetet e tjera pati mosmarrevshje me fqinjët dhe, sipas akteve finale, ato nuk quhen te koordinuar.

RTSH-ja, sipas ligjit ka ne dispozicion dy rrjete kombetare radio FM. Dy te tjere si dhe dy rrjetet e pakoordinuar jane vene ne dispozicion te operatoreve private.

Aktualisht ne disa vende te zhvilluara te Europes kane filluar transmetimet radiofonike dixhitale, tokesore nepermjet sistemit DAB-T, transmetimi radiofonik dixhital tokesor, mbeshtetur ne rekomandimet fillestare te konferencave nderkombetare te Gjeneves WARC 1988 dhe te Malages WARC 1992 per te arritur ne konferencen e planifikimit te zhvilluar ne Wisbaden ne vitin 1995.

Gjithashtu, mbeshtetur ne Konferencen e vendeve europiane te Chesterit ne vitin 1997, ne disa vende te zhvilluar ka filluar eksperimentimi i transmetimeve dixhitale tokesore nepermjet sistemit DBV\_T, Austria, Belgjika, Danimarka, Norvegjia, Zvicra etj ende nuk kane asnje transmetues te tille ne pune.

Mungesa pothuajse totale e marresave te pershtatshem fiks dhe te levizshem, si dhe investimet ne nje teknologji krejtesisht te re bejne qe keto transmetime, sipas studimeve dhe rekomandimeve te Bashkimit European te Radiotelevizioneve te bashkejetojne me transmetimet analogjike edhe per nje periudhe 25 vjecare. Vetem pas kesaj periudhe mund te flitet per transmetime krejtesisht radiotelevizive dixhitale tokesore.

Megjithate brezi 1452-1467 MHz, mund te vihet qe tani ne dispozicion te operatoreve private shqiptare, nese dikush kerkon te transmetoje ne sistemin DAB-T.

Fakti qe Shqiperia nuk i ka te regjistruara ne aktet nderkombetare kanalet e veta Kombetare, pra nuk i ka te mbrojtura ato ne raport me fqinjët, fakti qe mungon edhe sot studimi per potencialin e sakte te vendit te frekuencave per transmetime radiotelevizive Kombetare, qe do te mundesonte t'i garantohet teknikisht cdo operatori mbrojtja e tyre nga interferencat, detyrim ligjor per cdo operator, keto jane nje pjese e argumentave pse u amendua ligji nr 8410 dhe pse, sipas shtesave, u sanksionuan dy licensa private kombetare per transmetime televizive tokesore dhe kater licensa private kombetare per transmetime radio FM.

Frekuencat, e theksojme, jane pasuri kombetare me resurse te limituara, aq me teper ato per perdorim radioteleviziv. Rrjetet Kombetare televizive jane edhe me te limituara; shperndarja e tyre, perben nje strategji, qe si rregull, vendoset nga organe te larta te shtetit, qe kane mandat te tille. KKRT si rregullator dhe zbatues i ligjit operon ne baze te detyrimeve ligjore.

Nderkaq, ligji ben fjale per dy operatore televizive private kombetare qe transmetojne sinjalin ne rruge tokesore, pra nuk ka kufizim dhe nuk shprehet per mundesi te tjera, bie fjala, ne teknologji dixhitale, apo me satelit.

Ky nen nuk cenon konkurrencen as ne informacion dhe as ne treg. Vetem ne Tirane operojne 14 transmetues televizive te licensuar, dhe shtrirja e tyre sipas ligjit, deri ne kater prefektura, aktualisht perfshin per secilin mbi 50 % te popullsise se vendit. Me levizjen demografike te vrullshme drejt zonave urbane brenda nje periudhe licensimi secili mund te mbuloje deri 60 % te gjithe popullsise.

Nderkaq, ky eshte edhe tregu me i madh dhe me i fuqishem.

Te drejzat e komuniteteve per TV locale sa me afer interesave te tyre ngushtohen sa me i madh te jete numri i TV Kombetare. Frekuencat jane pasuri kombetare, pra dhe per banoret e zonave rurale e interesat e tyre, qe duhen konsideruar.

S'mund te thuhet se numri i kufizuar i transmetimeve kombetare radio-televizive eshte nje sakrilegj alashqipetar qe shkel standarte demokratike, kur shtete si Sllovenia apo Austria s'kane operatore TV private kombetare; Spanja, Anglia, Franca, Danimarka, Cekia, Kroacia etj i kane gjithashtu te pakte. Ne shumicen e ketyre vendeve, duke e pare median elektronike edhe si biznes, rekomandohen e po gjejne shtrirje transmetimet televizive me kabell apo me satelit, te koduara.

### Taksat, Pagesat, Teknologjite

Ne ligjin "Per sistemin e Taksave ne Republiken e Shqiperise", dhjetor 1998 dhe ne amendamentin e tij, perfshihen taksat per transmetimet RTV. Limitet e tyre jane caktuar pa mendimin e KKRT (ne ato kohe KKRT nuk ishte krijuar), Por ato jane te krahasuara me sherbimet e tjera, madje edhe ato per qellime humanitare, pra jo fitimprurese. Per cdo resurs te pasurise kombetare, aq me teper te kufizuar, si frekuencat, ka dhe duhet te kete taksa.

Fillimisht, ligji duhet zbatuar; qe s'do te thote se eshte i pandryshueshem.

Eshte fakt gjithashtu se prej tre vjetesh, askush nga operoret RTV ne transmetim s'ka paguar asnje lloj takse e pagese per veprimtarine e vet edhe si biznes.

Ne pagesat vjetore qe caktoi KKRT u mor ne konsiderate realiteti shqiptar, mundesite e biznesit shqiptar per te financuar, kurdohere me strategjine per te inkurajuar licencimin e sa me shume operoreve, sidomos lokale, per te qene sa me afer komuniteteve dhe interesave te tyre. Keto pagesa jane te diferencuara me numer popullsie per territorin qe mbulojne p.sh. operatore qe kerkojne te mbulojne Komuna e Bashki me popullsi 5000 deri ne 10 000 banore, duhet te paguajne, respektivisht per transmetimet radio lokale FM, 5000 dhe 7000 leke ne vit dhe per transmetimet TV lokale 10000 dhe 15 000 leke ne vit.

Me te lartat, per transmetim radio FM kombetare jane 1.5 milion leke ne vit dhe per TV kombetar 5 milion leke ne vit. Te gjitha keto pagesa, per rreth 80 subjekte te licensuar, arrinin shumen rreth 30 milion leke ne vit.

Per nje media te vertete, profesionale, te lire, konsiderojme se licenca s'eshte nje mundesi qe i ofrohet kujtdo. Ajo eshte nje privilegj, qe i jepet aplikuesit, te cilit, me ligj, i kerkohet te plotesoje disa kushte. Keto kushte dhe pagesat, garantojne, vec te tjerash seriozitet ne kete iniciative te lire.

Sidoqofte, me njohjen e plote te gjendjes, te tregut shqiptar te reklames dhe te mundesive te biznesit shqiptar, per te inkurajuar investimet ne median elektronike, KKRT rishqyrtoi pagesat vjetore dhe i uli ato ne masen mesatarisht 50%. Duke propozuar edhe rishikimin e ligjit per taksat per median elektronike, per t'i ulur ato, kemi bindjen se krijohet nje terren me i pershtatshem. Ulja e kostove te transmetimit qe vijne nga taksat e pagesat eshte ndihma me efikase qe jepet nga ata qe ndertojne programe e strategji, pra dhe nga ligjvenesit.

Praktika e deritanishme e kioskezimit te mediave elektronike, nese mund te shprehemi keshtu, ne kuptimin e radio tv kioskave pa leje, pa strukture programore, pa plan menaxhimi, pa buxhet, pa kontrata punesimi, pa detyrime fiskale, pa informacion objektiv e program cilesor dhe me shume "pa" te tjera, duhet te marre fund, ne radhe te pare per vet te ardhmen e mediave elektronike ne vendin tone.

Pervoja e vendeve te tjera, sidomos e atyreve te Evropes Qendrore dhe Lindore tregon se lindja e radiove e tv komerciale private e ka lehtesuar shprehjen e nje larmie zerash, opinionesh e programesh. Kjo pervoje nxjerr ne pah se rruga me e lehte per te krijuar diversitet eshte ndermjet radiove e TV te vogla , lokale, te cilat kane kerkesa modeste persa i perket kapitaleve.

Televizioni komercial i permasave te medha , ne te kundert, kerkon kohe per t'u zhvilluar, pasi duhet nje ekonomi tregu e zhvilluar qe te mund t'a mbroje ate, perderisa ai i mbeshtet te ardhurat ne reklama te konsiderueshme.

Teknologjite e industrise per prodhimin e transmetimin e programeve radiotelevizive ne boten e zhvilluar jane teper te avancuara. Ne mase po perhapet sistemi dixhital. Por keto teknologji jane teper te kushtueshme, aq me teper per te marre ne konsiderate projekte te medha, sidomos ne vendin tone.

Askush nuk i shet ato me lire vetem per faktin se Shqiperia eshte nje vend i varfer apo se biznesi shqiptar s'eshte i fuqishem.

E vetmja gje e lire tani per tani eshte shperblimi i punes, jo pa pasoja ne cilesine e saj.

Zhvillimi i industrise per prodhimin dhe transmetimin e programeve radiotelevizive do te zgjeroje tregun e punes edhe ne keto fusha: nje numer subjektesh, me dhe pa license prodhojne programe muzikore, disqe, audio e videokaseta.

License te kesaj natyre nuk i jep KKRT-ja, por ky prodhim, ky treg, do te hyje ne marredhenie me operatoret e transmetimeve radiotelevizive, sepse vete keta do te porositin programe, ne kerkim te kostove me te uleta.

Veprimtaria radiotelevizive do te rregullohet nga licensimi i transmetuesve radio e televizion, nga licensimi i prodhuesve te programeve, disqeve, kasetave etj, por edhe nga vete tregu.

Nje rol te madh duhet te luaje edhe Shoqata e transmetuesve e cila do te percaktoje rregulla te marredhenieve te ndersjellta, si partnere me njeri tjetrin, qe kerkojne zbatimin e ligjit per te gjitha, e njelloj per te gjitha, duke mos lejuar qe dikush t'u neneshetrohet detyrimeve fiskale e dikush jo, dikush te piratoje, etj e te futet ne treg si ne xhungel, me brryla, ose me forcen e te parit te xhungles e jo te ligjit.

Sigurisht, te suksesshem edhe ne treg, keto media do t'i bejne jo dredhat dhe brrylat, por menaxhues te afte.

Menaxhere te tille kuptojne, se pari, se kyç i suksesit eshte rritja e kredibilitetit te transmetuesit: pra profesionalizem i larte, pergjegjesi e larte para audiences. Pergjegjesi do te thote te gabosh sa me pak dhe po gabove, te zbatosh te drejten e korregjimit te pergjigjes, te pergenjeshtrimit.

Media e lire dhe e vertete do te thote, kur puntoreve te saj t'u njihet e drejta e profesionit, te mbrojtur nga ligji permes kontratave te rregullta, duke marre fund njehere e pergjithmone praktika e "punes se zeze", ndryshe ç'mesazhe lirie do te ofroje ai qe gdhihet kryeredaktor e ngriset ne rruge per "fajin" e vetem se ka prekur interesat e mbrapshta te dikujt ne pushtet, ne parti apo te bosit te vet?

KKRT eshte e vendosur te kerkoje nga subjektet radiotelevizive respektimin e ligjit, ne menyre qe askush te mos prodhoje e transmetoje programe jashte standarteve profesionale te kodifikuara, askush te mos anashkaloje kushtet e licences te parashikuara ne ligj.

KKRT do te jete kurdohere transparente ne veprimtarine e vendimet e veta.

KKRT kerkon mbeshtetje institucionale, sipas ligjit. Ne kerkojme mirekuptimin dhe mbeshtetjen e Qeverise dhe te Kuvendit per propozimet qe kemi bere per ndryshimin

e ligjit 8410 dhe atij per sistemin e taksave, qe synojne nje terren me te favorshem per mediat elektronike ne Shqiperi.

Kemi bashkepunuar e kemi gjetur mirekuptim me ERT, por edhe me MEPP per te zgjidhur hap pas hapi transferimin e disa frekuencave te okupuara nga subjekte rtv, qe aktualisht jane jashte bandave te rekomanduara nga UIT per keto sherbime.

Kemi bindjen e plote se keto zgjidhje do te ndihmojne ne sjelljen e shume subjekteve, ne veshtiresi te shumta, konform ligjit.

Keto zhvillime jane ne perputhje edhe me misionin e KKRT si organ qe ndjek e zgjidh nga afer problemet, duke favorizuar keshtu rolin si rregullator por eshe zbatues i ligjit.

Perfundimisht, per debatin e hapur ne media per monopolin e konkurencen, per taksat e pagesat, le te merren ne konsiderate edhe ç'ka u parashtrua me siper. Nderkaq asgje s'eshte e padiskutueshme, por deri me sot askush nga aplikuesit, as shoqata e transmetuesve nuk ka depozituar ne menyre institucionale prane KKRT sugjerimet e veta.

## Perfundime

Subjektet e licensuar per transmetime RTV, deri tani 81, dhe te tjera qe kane bere kerkese, flasin per nje shtrirje te gjere te medias elektronike, si informacion dhe si treg. Vetem ne Tirane, ne tregun me te madh, jane licensuar 14 operatore televiziv dhe 18 operatore radio FM. **Nuk ka asnje kryeqytet ne Europe ku te shikohen 14 programe televizive private te transmetuara ne rruge tokesore.**

Ne kete rast, nuk mund te flitet me per monopol te askujt, as mbi informacionin, as mbi tregun e ketyre mediave.

Profesionalizmi, informacioni i plote dhe i pavarur, prodhimi i programeve cilesore dhe menaxhimi efikas permes respektimit te ligjit do t'i beje ato te sukseshme apo do ti coje drejt falimentimit.

Ne strukturen programore te operatoreve te licensuar prodhimi nga vet ata eshte i paket, ka njeanshmeri e pasaktesi ne informacion, madje dhe shterpesi idesh, duke rene ne gracken e politikës.

Ngjarjet ne Kosove dhe pritja qe i beri populli Shqiptar nga Jugu ne Veri e nga Perendimi ne Lindje vellezerve ne hall dhe te rrezikuar, duke ndare shtepine, buken e paket e ujet e paket me ta ndricoi edhe median shqiptare, sic ndikoi dhe mund ta themi, emancipoi politiken shqiptare. Media, posacerisht ajo elektronike, pati besueshmerine me te madhe, pra audiencen me te madhe. Vitin e kaluar media elektronike u perballua me fushaten zgjedhore 2000, sfide qe pergjithesisht e perballoi me sukses.

KKRT hartoi me kete rast nje akt, KUJTESE, mbeshtetur ne Kodin Zgjedhor dhe ne ligjin 8410, e cila i u shpernda subjekteve zgjedhore dhe operatoreve. U verejt nje sjellje pergjithesisht korrekte dhe u fitua pervoje nga te gjitha palat.

Jane hartuar programe per te monitoruar profesionalisht ne nivel me cilesor zgjedhjet politike te ketij viti, duke siguruar ne kohe infrastrukture dhe trainimin e personelit.

Nderkaq, verehet se veset e politikës po shfaqen edhe si ves i medias, nje dukuri kjo jo vetem shqiptare.

Gjate ketij dhjete vjecari, qe daton shtypi i lire ne Shqiperi, limitet e femijerise ne jeten e njeriut, maredheniet e tij me politiken kane qene te dyfishta: gazetare qe e filluan

Gjate ketij dhjete vjecari, qe daton shtypi i lire ne Shqiperi, limitet e femijerise ne jeten e njeriut, maredheniet e tij me politiken kane qene te dyfishta: gazetare qe e filluan profesionin duke marre pjese ne procese demokratike e ndersjelltas, pra protagoniste te ngjarjeve ishin edhe kronikane te tyre.


Ndoshta ne kete mikroklima u kultivua ne media shpejt pezhishka e "kultures se rrenes" e cila, sipas specialistit te njohur Pol Never, eshte, citoj "unioni i fjaleve dhe i pozave ne te cilat jane angazhuar persona publike ne pergjigje te fteses se medias per ta". Pra media dhe persona publike e perdorin njeri tjetrin dhe ja hedhin reciprokisht njeri tjetrit duke luajtur keshtu me kredibilitetin e tyre, duke harruar te dy palet se s'ka e s'do te kete asnje marifet a mjeshteri qe do ta bente genjeshtren te vertete. Genjeshtera eshte genjeshter si tek mjeshtri dhe tek çiraku.

Me qe demokracia perfshin ne vetvete debatin publik dhe marrjen e hapet te vendimeve, shkembimi i lire i ideve, i opinioneneve dhe i informacioneve eshte thelbesor.

Pra media sherben edhe si forum per debat, si mund e duhet te sherbeje dhe debati ne media per ligjin 8410 dhe amendimi i tij. E rendesishme eshte qe gjithçka te behet ne menyre institucionale, duke respektuar ligjin, derisa ai te ndryshohet nga ligjvenesit.

**SEFEDIN ÇELA**

**Kryetar i Keshillit Kombetar te Radios dhe Televizionit**



170.44 Prot  
12.02.2001



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KUVENDI POPULLOR

Nr. 281 prot.

Tiranë, më 9.1.2001

Zotit Sefedin Çela  
Kryetar i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit  
Tiranë

Bashkëngjitur po ju nisim një letër të Komisionit të përhershëm parlamentar për  
Mjetet e Informimit Publik.

*Të nderohet me raportin  
dhe shkruan e ty për gjellëre për në Komision*

*mos e - 12-02-2001*

*fin*

Sekretari i Përgjithshëm

Artan Banushi





**KUVENDI POPULLOR**  
*Komisioni për Mjetet e Informimit Publik*

Nr. 281 Prot.

Tiranë, më 9 2 2001

**Zotit Sefedin Çela**  
**Kryetar i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit**  
**Tiranë**

Në zbatim të detyrimeve kushtetuese si dhe të ligjit nr. 8410, dt. 30. 9. 1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", neni 99, ju njoftojmë se duhet të depozitoni pranë Komisionit parlamentar për Mjetet e Informimit Publik raportin për veprimtarinë vjetore të KKRT - së, i cili do t'i paraqitet Kuvendit në seancë plenare më datë 15 mars 2001.

Raporti duhet të depozitohet pranë këtij komisioni 2 javë para paraqitjes së tij në seancën plenare të Kuvendit.

**Kryetari i komisionit**

**Halil Lalaj**